



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

Publikimi Teknik - TP 23

Kushtet dhe mënyra e transportimit të mallrave të rrezikshme përmes ajrit

Material udhëzues

Parathënie

Ky material udhëzues ka për qëllim informimin e subjekteve të involvuara në transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit për kërkesat e Rregullores Nr. 8/2014 dhe udhëzimin e tyre për implementimin e këtyre kërkesave.

Rregullorja e Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës (AACK) Nr. 8/2014 për Kushtet dhe mënyrën e transportimit të mallrave të rrezikshme përmes ajrit, e cila ka hyrë në fuqi më 25 tetor 2014, duke e zëvendësuar kështu Rregulloren Nr. 6/2011 të datës 25 qershor 2011, përmban kërkesa të reja, të cilat duhet të përmbushen nga subjektet të cilat pranojnë/përcjellin dhe bartin mallra të rrezikshme përmes ajrit, siç janë dërguesit, shpeditërit, ofruesit e shërbimeve të trajtimit në tokë, agjentët e trajtimit të mallrave dhe operatorët. Këto kërkesa, të cilat nuk kanë qenë të përfshira në rregulloren e vjetër, janë të harmonizuara me ndryshimet e fundit të standardeve ndërkombëtare të kësaj fushe, të përmbajtura në botimin e fundit të Instruksioneve Teknike për transport të sigurt të mallrave të rrezikshme përmes ajrit të ICAO-së.

Ky material udhëzues është i aplikueshëm për:

- ➔ dërguesit e ngarkesave përmes ajrit;
- ➔ shpeditërit;
- ➔ ofruesit e shërbimeve të trajtimit në tokë dhe agjentët e trajtimit të mallrave;
- ➔ operatorët postar;
- ➔ operatorët e mjeteve ajrore; dhe
- ➔ ofruesit e trajnimeve.

Ky material udhëzues është përgatitur nga AAC si doracak për rregullimin e kësaj fushe të aviacionit civil. Për shprehjet e ideve në këtë udhëzues mund të pretendohen të drejta autoriale në rast se ekziston dyshimi për një shkelje të tyre. Përgatitja e një publikimi tjetër të kësaj natyre mund të ndalohet përveç nëse dallon substancialisht nga ky udhëzues, dhe nëse nuk është kopje e tij.

Nëse keni nevojë për informata shtesë, ju lutem të na shkruani në adresën e mëposhtme:

Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës

Lagjja Arbëria

Rruga Ahmet Krasniqi p.n.

10000 Prishtinë

Republika e Kosovës

e-mail: infocaa@caa-ks.org

Tel: +38 1 38 248 629

Fax: +38 1 38 211 009

Dritan Gjonbalaj
Drejtore i Përgjithshëm

Lista e faqeve efektive

Titulli	Faqe	Nr. Rev.	Data efektive
Parathënie	2 nga 59	Original	10.02.2015
Lista e faqeve efektive	3 nga 59	Original	10.02.2015
Tabela e aprovimit	4 nga 59	Original	10.02.2015
Lista e distribuimit / Tabela e revidimit	6 nga 59	Original	10.02.2015
Tabela e përmbajtjes	7 nga 59	Original	10.02.2015
Definicionet dhe shkurtesat	8 nga 59	Original	10.02.2015
Aprovimi, lirimi dhe leja për transport të mallrave të rrezikshme	10 nga 59	Original	10.02.2015
Certifikata për mallra të rrezikshme	12 nga 59	Original	10.02.2015
Koordinatori për mallrat e rrezikshme	13 nga 59	Original	10.02.2015
Përgjegjësia e dërguesit	14 nga 59	Original	10.02.2015
Përgjegjësia e shpeditërit	15 nga 59	Original	10.02.2015
Përgjegjësia e Ofruesit të shërbimeve të trajtimit në tokë dhe e Agjentit të trajtimit të mallrave	16 nga 59	Original	10.02.2015
Transporti i mallrave të rrezikshme përmes postës	17 nga 59	Original	10.02.2015
Ofrimi i informacioneve	18 nga 59	Original	10.02.2015
Certifikimi i ofruesve të trajnimit	19 nga 59	Original	10.02.2015
Programet e trajnimit	20 nga 59	Original	10.02.2015
Numrat e regjistrimit të pjesëmarrësve	23 nga 59	Original	10.02.2015
Kualifikimet e instruktorëve	24 nga 59	Original	10.02.2015
Trajnimi përmes përdorimit të kompjuterit (CBT) / dhe mësimi përmes internetit (E-learning)	25 nga 59	Original	10.02.2015
Ruajtja e dokumenteve dhe shënimeve	26 nga 59	Original	10.02.2015
Dorëzimi i dokumenteve, shënimeve dhe raporteve mujore	27 nga 59	Original	10.02.2015

Raportimi i ndodhive me mallrat e rrezikshme	28 nga 59	Original	10.02.2015
Dispozitat kalimtare	29 nga 59	Original	10.02.2015
Shtojca 1 - Formular i kërkesës për lëshimin e aprovimit ose lirimit për bartjen e mallrave të rrezikshme	30 nga 59	Original	10.02.2015
Shtojca 2 - Formular i kërkesës për lëshimin e lejes për bartjen e mallrave të rrezikshme	34 nga 59	Original	10.02.2015
Shtojca 3 - Formular i kërkesës për lëshimin / ripërtëritjen e certifikatës për mallrat e rrezikshme	38 nga 59	Original	10.02.2015
Shtojca 4 - Formular i aplikimit për pranimin e koordinatorit për mallrat e rrezikshme	42 nga 59	Original	10.02.2015
Shtojca 5 - Formular i aplikimit për certifikimin e ofruesit të trajnimit	44 nga 59	Original	10.02.2015
Shtojca 6 - Formular i aplikimit për aprovimin e programit të trajnimit për mallrat e rrezikshme	47 nga 59	Original	10.02.2015
Shtojca 7 - Formular i aplikimit për alokimin e numrave të regjistrimit të pjesëmarrësve	54 nga 59	Original	10.02.2015
Shtojca 8 - Formular i aplikimit për pranimin e instruktorit për mallra të rrezikshme	55 nga 59	Original	10.02.2015
Shtojca 9 - Formular i raportit për transportin e mallrave të rrezikshme	57 nga 59	Original	10.02.2015
Shtojca 10 - Formular për raportim të ndodhive të mallrave të rrezikshme	58 nga 59	Original	10.02.2015

Tabela e aprovimit

	Emri dhe pozita	Data	Nënshkrimi
Përgatitur nga:	Bajram Xhemaili Inspektor, DSF	24.12.2014	
Autorizuar nga:	Kushtrim Musa Drejtore, DSF	29.01.2015	
Kontrolli i cilësisë:	Lendita Kika-Berisha Menaxhere e cilësisë	06.02.2015	
Aprovuar nga:	Dritan Gjonbalaj Drejtore i përgjithshëm	10.02.2015	

Lista e distribuimit

Kopje nr.	Vendndodhja	Media	Sasia
1	Libraria e AAC-së	Origjinali	1
2	Serveri i dosjeve të AAC-së	Digjitale	1

Tabela e revidimit

Nr. Rev.	Datë	Përgatitur nga:	Autorizuar nga:

Tabela e përmbajtjes

Parathënie.....	2
Lista e faqeve efektive	3
Tabela e aprovimit	4
Lista e distribuimit / Tabela e revidimit	6
Tabela e përmbajtjes	7
Definicionet dhe shkurtesat.....	8
Aprovimi, lirimi dhe leja për transport të mallrave të rrezikshme	10
Certifikata për mallra të rrezikshme	12
Koordinatori për mallrat e rrezikshme	13
Përgjegjësia e dërguesit	14
Përgjegjësia e shpeditërit	15
Përgjegjësia e Ofruesit të shërbimeve të trajtimit në tokë dhe e Agjentit të trajtimit të mallrave.....	16
Transporti i mallrave të rrezikshme përmes postës.....	17
Ofrimi i informacioneve.....	18
Certifikimi i ofruesve të trajnimit	19
Programet e trajnimit.....	20
Numrat e regjistrimit të pjesëmarrësve	23
Kualifikimet e instruktorëve	24
Trajnimi përmes përdorimit të kompjuterit (CBT) / dhe mësimi përmes internetit (E-learning)	25
Ruajtja e dokumenteve dhe shënimeve	26
Dorëzimi i dokumenteve, shënimeve dhe raporteve mujore.....	27
Raportimi i ndodhive me mallrat e rrezikshme	28
Dispozitat kalimtare	29
Shtojcat	30

Definicionet dhe shkurtesat

Agjent i trajtimit (Handling agent) - nënkupton kompaninë/organizatën e caktuar nga një kompani ajrore për të kryer funksione të ofruesit të shërbimit të trajtimit në tokë;

Aprovim (Approval) - nënkupton autorizimin e lëshuar nga autoriteti kompetent kombëtar për:

- a) transportin e mallrave të rrezikshme që janë të ndaluara në mjetet ajrore të udhëtarëve dhe/ose mjetet ajrore të mallrave, për të cilat në Instruksionet Teknike thuhet se mund të barten me aprovim; ose
- b) qëllime të tjera të parapara në Instruksionet Teknike;

Dërgues (Shipper) - nënkupton çdo person, organizatë apo organ i cili ka të drejtë për të përgatitur dërgesën për transport;

Instruksione Teknike (Technical Instructions) - nënkupton botimin e fundit të Instruksioneve Teknike të ICAO-së për Transportin e sigurt të mallrave të rrezikshme përmes ajrit (Doc 9284), të aprovuara dhe publikuara me vendim të Këshillit të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil;

Leje (Permission) - nënkupton autorizimin e lëshuar nga Autoriteti për transportin e armëve dhe municionit, duke përfshirë eksplozivët, si dhe të mallrave tjera të rrezikshme, si gazrat e dëmshme ose toksike, karburantet nukleare dhe materialet radioaktive.

Lirim (Exemption) - nënkupton autorizimin, përveç aprovimit, të lëshuar nga autoriteti kompetent kombëtar që mundëson shmangie nga dispozitat e Instruksioneve Teknike.

Mallra të rrezikshme (Dangerous goods) - nënkupton artikujt ose substancat që janë në gjendje të paraqesin rrezik për shëndetin, sigurinë, pronën apo mjedisin dhe që janë të paraqitura në listën e mallrave të rrezikshme në Instruksionet Teknike, apo të cilat janë të klasifikuara sipas Instruksioneve Teknike;

Ofrues i trajnimeve (Training provider) - nënkupton personin, organizatën apo ndërmarrjen që ofron trajnime;

Operator (Operator) - nënkupton personin, organizatën apo ndërmarrjen e angazhuar ose që ofron për t'u angazhuar në operimet me mjete ajrore;

Operator i emëruar postar (Designated postal operator) - nënkupton çdo entitet qeveritar apo joqeveritar të emëruar zyrtarisht nga Republika e Kosovës për të ofruar shërbime postare dhe për të përmbushur, në territorin e vet, detyrimet që dalin nga Konventa e Unionit Postar Universal (UPU);

Përrjashtim (Exception) - nënkupton dispozitën e kësaj Rregulloreje dhe Instruksioneve Teknike e cila përjashton ndonjë artikull të caktuar të mallrave të rrezikshme nga kërkesat që normalisht janë të zbatueshme për atë artikull;

Postë (Mail) - nënkupton dërgesat e korrespondencës dhe gjërave tjera të ofruara nga shërbimet postare dhe të destinuara për livrim nga shërbimet postare në përputhje me rregullat e Unionit Postar Universal (UPU).

Shpeditër (Freight forwarder) - nënkupton personin ose organizatën që ofron shërbimin e aranzhimit të transportit të mallrave përmes ajrit;

AACK - Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës

AOC - Certifikata e Operatorit Ajror

EU-OPS - Rregullorja e Këshillit (EEC) Nr. 3922/91 e datës 16 dhjetor 1991 mbi harmonizimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative në fushën e aviacionit civil, siç është ndryshuar

FIATA - Asociacioni Ndërkombëtar i Federatës së Shpeditërëve

ICAO - Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil

CBT - Trajnimi përmes përdorimit të kompjuterit

UPU - Unioni Postar Universal

Aprovimi, lirimi dhe leja për transport të mallrave të rrezikshme

Aprovimi

AACK mund të lëshojë aprovim për të lejuar transportin e mallrave të rrezikshme të ndaluara në mjetet ajrore të udhëtarëve dhe/ose mallrave, me kusht që në rastet e tilla arrihet një nivel i përgjithshëm i sigurisë në transport i cili është i barabartë me nivelin e sigurisë të përcaktuar në Instruksionet Teknike.

Në mungesë të një reference të veçantë në Instruksionet Teknike që lejon lëshimin e aprovimit, mund të kërkohet lëshimi i një lirimi.

Formulari i kërkesës për lëshimin e aprovimit ose lirimit për bartjen e mallrave të rrezikshme të referuara më lartë është i bashkangjitur këtij Publikimi Teknik si *Shtojca 1* (AACK/DSF/DG-FRM 01).

Lirimi

Me përjashtim të artikujve dhe substancave që janë të ndaluara për transport përmes ajrit në të gjitha rrethanat, AACK mund të lëshojë lirim nga dispozitat e Instruksioneve Teknike me kusht që operatori të demonstrojë që niveli i përgjithshëm i sigurisë në transport të jetë i barabartë me nivelin e sigurisë të përcaktuar në Instruksionet Teknike në rastet e:

- a) urgjencës ekstreme, ose
- b) kur format tjera të transportit janë të papërshtatshme, ose
- c) kur përmbushja e plotë e kërkesave të përcaktuara është në kundërshtim me interesin e përgjithshëm.

Në rastin e mbi-fluturimeve, kur nuk është i aplikueshëm asnjëri nga kriteret për lëshimin e lirimit, lirimi mund të jepet vetëm në bazë të besimit që është arritur një nivel ekuivalent i sigurisë në transportin ajror.

Udhëzimet për trajtimin e aplikacioneve për lirime, duke përfshirë edhe shembuj të emergjencave ekstreme, mund të gjenden në Shtojcën e Instruksioneve Teknike (Pjesa S-1, 1.2 dhe 1.3).

Leja

Sipas nenit 57 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, armët dhe municioni, duke përfshirë eksplozivët, mund të barten në bord të mjetit ajror vetëm:

- me leje të veçantë me shkrim të AACK-së,
- nën mbikëqyrjen e pilotit komandues, dhe
- në përputhje të plotë me legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Sipas nenit 59 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, mallrat tjera të rrezikshme, si gazrat e dëmshme ose helmuese, karburantet nukleare dhe materialet radioaktive mund të barten vetëm:

- me leje të veçantë me shkrim të AACK-së, dhe
- vetëm sipas kushteve të përcaktuara nga AACK në rregulloret e tij zbatuese të LAC-it, të cilat marrin parasysh rregullat dhe rregulloret ekzistuese vendore dhe ndërkombëtare.

Formulari i kërkesës për lëshimin e lejes për bartjen e mallrave të rrezikshme të referuara më lartë është i bashkangjitur këtij Publikimi Teknik si *Shtojca 2 (AACK/DSF/DG-FRM 02)*.

Certifikata për mallra të rrezikshme

Të gjitha subjektet (dërguesit, shpeditërit, ofruesit e shërbimeve të trajtimit në tokë, agjentët e trajtimit të mallrave dhe operatorët) që dëshirojnë të pranojnë dhe përcjellin mallra të rrezikshme duhet të aplikojnë në AACK për lëshimin e certifikatës, e cila do të dëshmonte kompetencën e tyre për kryerjen e këtyre operimeve.

Subjekti që aplikon për lëshimin/ripërtëritjen e certifikatës për mallrat e rrezikshme duke të plotësojë dhe dorëzojë formularin e aplikimit të bashkangjitur këtij Publikimi Teknik si *Shtojca 3 (AACK/DSF/DG-FRM 03)*, si dhe të krijojë Procedura Standarde Operative - SOP, të emërojë një koordinator për mallrat e rrezikshme dhe të ketë qasje në legjislacionin e vlefshëm të mallrave të rrezikshme.

Operatorët ajror, vendi kryesor i biznesit i të cilëve është në Bashkimin Evropian, të cilëve Certifikata e Operatorit Ajror - AOC i është lëshuar dhe që operojnë në përputhje me kërkesat e Aneksit III të Rregullores (EEC) 3922/91 (EU-OPS) të ndryshuar, nuk janë të detyruar që të marrin certifikatën për mallrat e rrezikshme, me kusht që të kenë autorizim/aprovim të veçantë për transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit, të lëshuar nga autoriteti kompetent i cili e ka lëshuar AOC-në.

Koordinatori për mallra të rrezikshme

Një ose më shumë koordinatorë për mallrat e rrezikshme duhet të caktohen nga çdo dërgues, shpeditur, ofrues i shërbimeve të trajtimit në tokë dhe agjent i trajtimit të mallrave i aprovuar dhe operatorët, që kryejnë aktivitete në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit. Koordinatori mund të jetë menaxheri ose ndonjë person tjetër i ndërmarrjes, ose ndonjë person që nuk është i punësuar drejtpërdrejtë nga kjo ndërmarrje, me kusht ai/ajo të jetë i aftë të kryejë detyrat e koordinatorit për mallrat e rrezikshme.

Detyrat të cilat duhet t'i kryej koordinatori për mallrat e rrezikshme janë të listuara në Nenin 14.3 të Rregullores Nr. 8/2014.

Formulari i aplikimit për pranimin e koordinatorit për mallrat e rrezikshme është i bashkangjitur këtij Publikimi Teknik si **Shtojca 4** (AACK/DSF/DG-FRM 04). Formularit duhet t'i bashkëngjitet dëshmia për kryerjen e trajnimit për mallrat e rrezikshme për kategorinë 6, dëshmia për përvojën e nevojshme të punës dhe biografia (CV-a).

Përgjegjësia e dërguesit

Para se dërguesi të ofrojë ndonjë pako ose mbi-paketim të mallrave të rrezikshme për transport përmes ajrit, duhet të sigurojë:

- a) që mallrat nuk janë të ndaluara për transport përmes ajrit;
- b) nëse mallrat janë të ndaluara për t'u transportuar përmes ajrit pa aprovim, dërguesi është i obliguar që të marrë aprovimin, nëse kështu është specifikuar në Instruksionet Teknike;
- c) që mallrat të jenë të klasifikuara, paketuara, shënuara dhe etiketuara në mënyrë të duhur dhe të shoqëruara nga një dokument i transportit të mallrave të rrezikshme i ekzekutuar në mënyrë të duhur, siç është specifikuar në Rregulloren Nr. 8/2014 dhe në Instruksionet Teknike.

Përgjegjësia e shpeditërit

Shpeditëri i cili në emër të dërguesit kryen klasifikimin, paketimin dhe shënjimin e dërgesës duhet të sigurojë që dispozitat për klasifikimin, paketimin dhe shënjimin në Rregulloren Nr. 8/2014 dhe në Instruksionet Teknike të përmbushen edhe atëherë kur dërguesi nënshkruan dokumentin e transportit.

Përveç dispozitave të Rregullores Nr. 8/2014 që aplikohen për transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit, shpeditërit e angazhuar në aktivitete të shpedicionit duhet të aplikojnë edhe Kushtet e Përgjithshme të Asociacionit Ndërkombëtar të Federatës së Shpeditëreve (FIATA).

Përgjegjësia e Ofruesit të shërbimeve të trajtimit në tokë dhe e Agjentit të trajtimit të mallrave

Ofruesi i shërbimeve të trajtimit në tokë dhe agjenti i trajtimit të mallrave në pajtim me dispozitat e marrëveshjes për shërbimet e trajtimit në tokë, merr përsipër përgjegjësinë e operatorit të mjetit ajror për përmbushjen e kërkesave të Neneve 17.2, 17.3, 17.4, 17.5, 17.6, 17.8, 17.9, 17.10, 17.12, 17.13, 17.14, 17.15, 17.16, 17.17, 17.18 dhe 17.19 të Rregullores Nr. 8/2014, kur kjo është e aplikueshme.

Ofruesi i shërbimeve të trajtimit në tokë dhe agjenti i trajtimit të mallrave duhet të mbajë shënime për të gjithë operatorët e aprovuar për transport të mallrave të rrezikshme përmes ajrit nga aeroporti në të cilin ofruesi i shërbimeve ushtron veprimtarinë e vet. Këto shënime duhet t'i dorëzohen AACK-së, sipas kërkesës.

Transporti i mallrave të rrezikshme përmes postës

Në përputhje me Konventën e Unionit Postar Universal (UPU), mallrat e rrezikshme nuk lejohen në postë, përveç atyre të përjashtuara që janë të listuara në Nenin 20.2 të Rregullores Nr. 8/2014.

AACK-ja rishikon dhe aprovon procedurat e operatorëve të emëruar postar për kontrollin e futjes së mallrave të rrezikshme në postë për transport ajror.

Operatori i emëruar postar nuk guxon të pranojë mallra të rrezikshme të referuara në Nenin 20.2 a), b) dhe c) të Rregullores Nr. 8/2014, pa aprovim specifik të AACK-së.

Para se operatori i emëruar postar të mund të fillojë pranimin e baterive litiumi të referuara në nenin 20.2 d) dhe e) të Rregullores Nr. 8/2014, ai duhet të marrë një aprovim të veçantë nga AACK-ja.

Ofrimi i informacioneve

Organizata (operatori ekonomik) ose sipërmarrësi, i cili nuk është operator (p.sh. agjencitë e udhëtimit), që marrin pjesë në transportin e udhëtarëve përmes ajrit, duhet t'i ofrojë informacione udhëtarëve të vet për llojet e mallrave të rrezikshme të cilat janë të ndaluara për t'u bartur në bord. Si minimum, këto informacione duhet të jepen përmes njoftimit në ato vende ku udhëtarët bien në kontakt me to.

Operatori apo agjenti i trajtimit i operatorit duhet të sigurojë që njoftimet të cilat ofrojnë informacione në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme janë të mjaftueshme në numër, janë të ekspozuara dukshëm dhe ofrohen në vendin(et) e dukshëm në pikat e pranimi të ngarkesave, për të paralajmëruar dërguesit/agjentët për çdo mall të rrezikshëm që mund të jetë i përfshirë në dërgesën(at) e tyre të ngarkesave. Këto njoftime duhet të përfshijnë shembuj vizual të mallrave të rrezikshme, duke përfshirë edhe bateritë.

Operatorët, dërguesit dhe subjektet tjera të përfshira në transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit duhet t'u ofrojë personelit të tyre informata që do t'u mundësonin atyre përmbushjen e përgjegjësisë së tyre në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme dhe duhet të ofrojë instruksione për veprimet që duhet të ndërmerren në rastet e emergjencave që shfaqen dhe përfshijnë mallrat e rrezikshme.

Certifikimi i ofruesve të trajnimit

Ofruesi i trajnimit është një organizatë që ka staf adekuat, pajisje, vepron në një mjedis të duhur dhe kryen trajnimin teorik në përputhje me programin e trajnimit të aprovuar nga AACK-ja.

Organizata e cila ka për qëllim të kryej trajnime për mallrat e rrezikshme duhet të aprovohet nga AACK-ja. Formulari i aplikimit për certifikimin e ofruesit të trajnimit është i bashkangjitur këtij Publikimi Teknik si *Shtojca 5 (AACK/DSF/DG-FRM 05)*.

Ofruesi i trajnimit duhet të sigurojë kushte minimale teknike dhe higjienike të objekteve në të cilat kryhet trajnimi në përputhje me rregulloret në fuqi për arsimin.

Ofruesi i trajnimit duhet të sigurojë që instruktorët pranojnë ndryshimet e fundit të Instruksioneve Teknike dhe/ose botimet e reja të Manualit të IATA-së për Mallrat e Rrezikshme dhe materialet e trajnimit.

Ofruesi i trajnimit është përgjegjës për detyrimet tjera të listuara në Nenin 23.5 të Rregullores Nr. 8/2014.

Programet e trajnimit

Ofruesit e trajnimeve duhet të krijojnë dhe mirëmbajnë programe fillestare dhe periodike të trajnimit për mallrat e rrezikshme për:

- a) dërguesit e mallrave të rrezikshme, duke përfshirë paketuesit dhe personat ose organizatat që marrin përsipër përgjegjësitë e dërguesve;
- b) operatorët;
- c) agjencitë e trajtimit në tokë të cilat në emër të operatorit kryejnë pranimin, trajtimin, ngarkimin, shkarkimin, transferimin ose procesimin tjetër të ngarkesave, postës apo mallrave (furnizimeve);
- d) agjencitë e trajtimit në tokë të vendosura në aeroport të cilat, në emër të operatorit, kryerjen procesimin e udhëtarëve;
- e) agjencitë, që nuk janë të vendosura në aeroport, të cilat, në emër të operatorit, kryejnë regjistrimin (check-in) e udhëtarëve;
- f) shpeditërit;
- g) agjencitë e angazhuara në kontrollin e sigurimit të udhëtarëve dhe bagazhit të tyre dhe/ose ngarkesave, postës apo mallrave (furnizimeve); dhe
- h) operatorët e emëruar postar.

Trajnimi dhe vlerësimi i bazuar në kompetencës duhet të kryhet në përputhje me dispozitat e përgjithshme të përfshira në Kapitullin 2 të Procedurave të ICAO-së për Shërbimet e Navigacionit Ajror - Trajnimi (PANS-TRG, Doc 9868).

Personeli duhet të trajnohet për kërkesat proporcionalisht me përgjegjësitë e tyre. Personeli i identifikuar në kategoritë e specifikuara në Tabelën 1, 2 ose 3 duhet të jetë i trajnuar ose trajnimi duhet të verifikohet para se personi të kryej ndonjë nga detyrat e specifikuara në tabelën 1, 2 ose 3.

Trajnimi periodik duhet të ofrohet brenda 24 muajve nga trajnimi i kaluar për t'u siguruar që njohuritë të mbesin aktuale. Megjithatë, në qoftë se trajnimi periodik kryhet brenda tre muajve të fundit të vlefshmërisë së trajnimit të kaluar, periudha e vlefshmërisë shtrihet nga muaji në të cilin trajnimi periodik është kryer deri në 24 muaj nga muaji i skadimit të trajnimit të kaluar.

Personeli i sigurimit duhet të trajnohet në përputhje me Instruksionet Teknike pavarësisht nëse operatori, përmes së cilit transportohen udhëtarët ose ngarkesat, bart mallra të rrezikshme si ngarkesë.

Programet e trajnimit për mallrat e rrezikshme të kërkuara sipas pikës b) dhe h) duhet t'i nënshtrohen rishikimit dhe aprovimit nga AACK-ja.

Programet e trajnimit për mallrat e rrezikshme përveç atyre të kërkuara sipas pikës b) dhe h) po ashtu duhet t'i nënshtrohen rishikimit dhe aprovimit nga AACK-ja.

Formulari i aplikimit për aprovimin e programit të trajnimit për mallrat e rrezikshme referuar si më lartë në këtë Publikim Teknik, i është bashkangjitur këtij Publikimi Teknik si **Shtojca 6 (AACK/DSF/DG-FRM 06)**.

Temat e lidhura me transportin e mallrave të rrezikshme, me të cilat duhet të jenë të familjarizuara kategoritë e ndryshme të personelit, janë paraqitur në Tabelën 1.

Personeli i operatorëve që nuk bartin mallra të rrezikshme si ngarkesa ose postë duhet të trajnohet në përputhje me përgjegjësitë e tyre. Temat me të cilat duhet të jenë të familjarizuara kategoritë e ndryshme të personelit të tyre janë paraqitur në Tabelën 2.

Personeli i operatorëve të emëruar postar duhet të trajnohet në përputhje me përgjegjësitë e tyre. Temat me të cilat duhet të jenë të familjarizuara kategoritë e ndryshme të personelit të tyre janë paraqitur në Tabelën 3.

Tabela 1 - Përmbajtja e kurseve të trajnimit për operatorët që bartin mallra të rrezikshme si ngarkesë apo postë

Aspektet minimale të transportit të mallrave të rrezikshme përmes ajrit me të cilat ata duhet të jenë të familjarizuar	Dërguesit dhe paketuesit		Shpeditëret			Operatorët dhe agjentët e trajtimit në tokë						Personeli i sigurimit
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
Filozofia e përgjithshme	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X
Kufizimet	X		X	X	X	X	X	X	X	X	X	X
Kërkesat e përgjithshme për dërguesit	X		X			X						
Klasifikimi	X	X	X			X						X
Lista e mallrave të rrezikshme	X	X	X			X				X		
Kërkesat për paketim	X	X	X			X						
Etiketimi dhe shënjimi	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X
Dokumenti i transportit të mallrave të rrezikshme dhe dokumentet tjera relevante	X		X	X		X	X					
Procedurat e pranimit						X						
Njohja e mallrave të rrezikshme të padeklaruara	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X
Procedurat e deponimit dhe ngarkimit					X	X		X		X		
Njoftimi i pilotëve						X		X		X		
Dispozitat për udhëtarët dhe ekuipazhin	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X
Procedurat për rastet emergjente	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X

KATEGORIA

1. Dërguesit dhe personat që marrin përsipër përgjegjësitë e dërguesve
2. Paketuesit
3. Personeli i shpeditëreve i përfshirë në procesimin e mallrave të rrezikshme
4. Personeli i shpeditëreve i përfshirë në procesimin e ngarkesave ose postës (përveç mallrave të rrezikshme)
5. Personeli i shpeditëreve i përfshirë në trajtimin, deponimin dhe ngarkimin e ngarkesave ose postës
6. Personeli i operatorëve dhe agjentëve të trajtimit në tokë që pranon mallrat e rrezikshme
7. Personeli i operatorëve dhe agjentëve të trajtimit në tokë që pranon ngarkesat ose postën (përveç mallrave të rrezikshme)
8. Personeli i operatorëve dhe agjentëve të trajtimit në tokë i përfshirë në trajtimin, deponimin dhe ngarkimin e ngarkesave ose postës dhe bagazhit
9. Personeli i shërbimit të udhëtarëve
10. Anëtarët e ekuipazhit të fluturimit, mbikëqyrësit e ngarkesës dhe planifikuesit e ngarkimit
11. Anëtarët e ekuipazhit (përveç anëtarëve të ekuipazhit të fluturimit)
12. Personeli i sigurimit i cili është i përfshirë në skenimin e udhëtarëve dhe bagazhit të tyre si dhe të ngarkesave ose postës, p.sh. skenuesit e sigurimit, mbikëqyrësit e tyre dhe personeli i përfshirë në implementimin e procedurave të sigurimit

Tabela 2 - Përmbajtja e kurseve trajnuese për operatorët që nuk bartin mallra të rrezikshme si ngarkesë apo postë

Përmbajtja	7	8	9	10	11
Filozofia e përgjithshme	X	X	X	X	X
Kufizimet	X	X	X	X	X
Etiketimi dhe shënjimi	X	X	X	X	X
Dokumenti i transportit të mallrave të rrezikshme dhe dokumentet tjera relevante	X				
Njohja e mallrave të rrezikshme të padeklaruara	X	X	X	X	X
Dispozitat për udhëtarët dhe ekuipazhin	X	X	X	X	X
Procedurat për rastet emergjente	X	X	X	X	X

KATEGORIA

7. Personeli i operatorëve dhe agjentëve të trajtimit në tokë që pranon ngarkesat ose postën (përveç mallrave të rrezikshme)
8. Personeli i operatorëve dhe agjentëve të trajtimit në tokë i përfshirë në trajtimin, deponimin dhe ngarkimin e ngarkesave ose postës dhe bagazhit
9. Personeli i shërbimit të udhëtarëve
10. Anëtarët e ekuipazhit të fluturimit, mbikëqyrësit e ngarkesës dhe planifikuesit e ngarkimit
11. Anëtarët e ekuipazhit (përveç anëtarëve të ekuipazhit të fluturimit)

Tabela 3 - Përmbajtja e kurseve trajnuese për personelin e operatorëve të emëruar postar

Aspektet minimale të transportit të mallrave të rrezikshme përmes ajrit me të cilat ata duhet të jenë të familjarizuar	Operatorët e emëruar postar		
	A	B	C
Filozofia e përgjithshme	X	X	X
Kufizimet	X	X	X
Kërkesat e përgjithshme për dërguesit	X		
Klasifikimi	X		
Lista e mallrave të rrezikshme	X		
Kërkesat për paketim	X		
Etiketimi dhe shënjimi	X	X	X
Dokumenti i transportit të mallrave të rrezikshme dhe dokumentet tjera relevante	X	X	
Pranimi i mallrave të rrezikshme të listuara në Pjesën 1;2.3.2 të IT	X		
Njohja e mallrave të rrezikshme të padeklaruara	X	X	X
Procedurat e deponimit dhe ngarkimit			X
Dispozitat për udhëtarët dhe ekuipazhin	X	X	X
Procedurat për rastet emergjente	X	X	X

KATEGORIA

- A. Personeli i operatorëve të emëruar postar i përfshirë në pranimin e postës që përmban mallra të rrezikshme
- B. Personeli i operatorëve të emëruar postar i përfshirë në procesimin e postës (përveç mallrave të rrezikshme)
- C. Personeli i operatorëve të emëruar postar i përfshirë në trajtimin, deponimin dhe ngarkimin e postës

Numrat e regjistrimit të pjesëmarrësve

Certifikatat e lëshuara për pjesëmarrësit e suksesshëm duhet të përmbajnë numrat e regjistrimit të pjesëmarrësve. Numri duhet të jetë unik për secilën certifikatë.

Ofruesi i trajnimit duhet të aplikojë pranë AACK-së duke përdorur formularin e aplikimit për alokimin e numrave të regjistrimit të pjesëmarrësve të bashkangjitur këtij Publikimi Teknik si *Shtojca 7* (AACK/DSF/DG-FRM 07).

Kualifikimet e instruktorëve

Instruktorët të cilët ligjërojnë programet fillestare dhe periodike të trajnimit për mallra të rrezikshme, si minimum, duhet të plotësojnë kërkesat e përcaktuara në Nenet 30.1, 30.2, 30.3 dhe 30.4 të Rregullores Nr. 8/2014.

AACK-ja do të mbajë shënimet për instruktorët që janë të pranuar dhe të cilët vazhdojnë t'i plotësojnë kërkesat për të ligjëruar trajnime të mallrave të rrezikshme. Formulari i aplikimit për pranimin e instruktorit për mallra të rrezikshme i është bashkangjitur këtij Publikimi Teknik si *Shtojca 8 (AACK/DSF/DG-FRM 08)*.

Trajnimi përmes përdorimit të kompjuterit (CBT) / dhe mësimi përmes internetit (E-learning)

Ofruesi i trajnimit asnjëherë nuk duhet të përjashtojë tërësisht instruktorët gjatë ligjërimit të trajnimit të mallrave të rrezikshme. Përdorimi i metodave të përziera të trajnimit është mënyra më e përshtatshme për përmbushjen e kërkesave rregullatore.

Kërkesat që duhet t'i plotësojnë ofruesit e trajnimit për të mbajtur trajnime përmes përdorimit të CBT-së dhe/ose mësimi përmes internetit, janë të përcaktuara në Nenin 31.2 të Rregullores Nr. 8/2014.

Ruajtja e dokumenteve dhe shënimeve

Përveç kërkesave për ruajtjen e dokumenteve dhe shënimeve për operatorët e mjeteve ajrore, të cilat janë të përcaktuara në Nenin 32.1, 32.2 dhe 32.3 të Rregullores Nr. 8/2014, kërkesa të tilla ka edhe për dërguesit e mallrave të rrezikshme, të cilët janë të obliguar të ruajnë dokumentet për transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit për të paktën tre muaj pas fluturimit.

Dorëzimi i dokumenteve, shënimeve dhe raporteve mujore

Nenet 33.1, 33.2 dhe 33.3 të Rregullores Nr. 8/2014 përcaktojnë kërkesat për dorëzimin e dokumenteve, shënimeve dhe raporteve mujore nga operatorët, dërguesit, shpeditërit ose ofruesit e shërbimeve të trajtimit në tokë.

Operatorët dhe ofruesit e shërbimeve të trajtimit në tokë duhet t'i paraqesin AACK-së një raport mujor me shkrim. Formulari i raportit për transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit i është bashkangjitur këtij Publikimi Teknik si ***Shtojca 9*** (AACK/DSF/DG-FRM 09).

Raportimi i ndodhive me mallrat e rrezikshme

Dërguesi, shpediteri, dogana, operatori i emëruar postar, ofruesi i shërbimeve të trajtimit në tokë, agjenti i trajtimit të mallrave, operatori dhe të gjitha subjektet tjera vendi kryesor i biznesit i të cilave ndodhet në Republikën e Kosovës, kur mallrat e rrezikshme janë të pranishme në kohën e ndodhisë, pa marrë parasysh nëse mallrat e rrezikshme ndodhen në ngarkesë, postë ose bagazh, duhet t'i nënshtrohen kërkesave të raportimit të përcaktuara në Nenin 35 të Rregullores Nr. 8/2014 dhe në Rregulloren 01/2009 për raportimin e ndodhive në aviacionin civil, si dhe duhet të informojnë AACK-në.

Formulari për raportim të ndodhive të mallrave të rrezikshme i është bashkangjitur këtij Publikimi Teknik si ***Shtojca 10*** (AACK/DSF/OR-FRM 04).

Dispozitat kalimtare

Dërguesit, shpeditërit, ofruesit e shërbimeve të trajtimit në tokë, agjentët e trajtimit të mallrave dhe operatorët që nuk posedojnë Certifikatë të Operatorit Ajror (AOC) dhe që nuk operojnë në përputhje me kërkesat e Aneksit III të Rregullores (EEC) 3922/91 (EU-OPS), duhet t'i zbatojnë plotësisht dispozitat e Rregullores Nr. 8/2014, dhe për të vazhduar me kryerjen e aktiviteteve që lidhen me transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit, duhet të posedojnë certifikatë për mallrat e rrezikshme të lëshuar nga AACK-ja, në pajtim me Rregulloren Nr. 8/2014, jo më vonë se më 31 mars 2015.

Operatori i emëruar postar duhet t'i zbatojë plotësisht dispozitat e Neneve 20.5, 25.6 dhe 25.11 të Rregullores Nr. 8/2014, jo më vonë se më 31 mars 2015.

Ofruesit e trajnimit duhet t'i zbatojë plotësisht dispozitat e Rregullores Nr. 8/2014, në mënyrë që të vazhdojnë kryerjen e aktiviteteve që lidhen me trajnimin për mallrat e rrezikshme dhe duhet të posedojnë certifikatën e ofruesit të shërbimeve të trajnimit të lëshuar në pajtim me Rregulloren Nr. 8/2014, jo më vonë se më 31 mars 2015.

Shtojca 1: Formulari i aplikimit për aprovimin ose lirimin e bartjes së mallrave të rrezikshme nën kushte të veçanta



Application for Approval / Exemption to Carry Dangerous Goods under Special Circumstances

(§ 6 and 7 of the Regulation 8/2014 on the Conditions and methods of transporting dangerous goods by air)

Note: – this form applies to requests for Approval / Exemption for the transport of dangerous goods that are forbidden for transport by passenger and/or cargo aircraft as required by Articles 6 and 7 of the Regulation 8/2014 on the Conditions and methods of transporting dangerous goods by air. Application should be made at least 10 days before the date of the flight on which the dangerous goods are to be carried and should be submitted to the:

Civil Aviation Authority of Kosovo
Flight Safety Department
Arbëria District, Ahmet Krasniqi Street - 10000 Prishtina
Republic of Kosovo

Failure to complete this form in full may result in a delay in processing the application. The issuing of this form does not itself constitute an authorization to carry dangerous goods

1. APPLICANT DETAILS

Organisation / Company:		Tel:	
		Fax:	
Name of responsible person:		e-mail:	

2. SHIPPER

Organisation / Company:		Tel:	
		Fax:	
Name of responsible person:		e-mail:	

3. CONSIGNEE

Organisation / Company:		Tel:	
		Fax:	
Name of responsible person:		e-mail:	

4. FLIGHT DETAILS

Operator				EU-OPS Operator?	☐ Yes	☐ No
A/C Type		Date of Flight	____/____/____	Flight Number		
Departure Airport		Transit Airport		Destination Airport		
AWB Number						

5. REASON FOR TRANSPORTING THE ARTICLES OR SUBSTANCES BY AIR**6. STATEMENT ON THE ACHIEVED LEVEL OF SAFETY DURING TRANSPORT WHICH IS EQUIVALENT TO THAT PROVIDED IN THE TECHNICAL INSTRUCTIONS****7. DANGEROUS GOODS**

UN No.	Proper Shipping Name	Class / Division	Packing Instruction	Number of packages	Type of package	Gross mass (kg)
Total						

8. ADDITIONAL INFORMATION

Import/Export license no. and Expiry Date <i>(if applicable please attach)</i>	
Commercial Names of Items and Quantity:	
Proposed packaging:	
Specific handling required:	
Specific unloading point at destination airport:	
Specific loading point at departure airport:	
Specific emergency response information:	
Other:	
<i>Please use additional sheet if necessary</i>	

9. APPENDICES

Please attach copies of the following documents:	
☐	Air Operator Certificate (AOC)
☐	Operations Specifications
☐	Approval for carriage of weapons of war and munitions of war granted by the State responsible for AOC
☐	Relevant pages of the Operations Manual or other document (describing policy and procedures for carriage dangerous goods and weapons of war)
☐	Initial Exemption issued by the State of origin
☐	Shipper's Declaration for Dangerous Goods
☐	Air waybill
☐	Evidence that prescribed fee in amount of 70,00 HRK is paid (see NOTE)
Other supported document	

10. INFORMATION PROVIDED IN THIS APPLICATION FORM AND ITS APPENDICES ARE CORRECT AND TRUE TO THE BEST OF MY KNOWLEDGE AND BELIEF

Name		Position	
Signature		Date	_____

11. CAA INSPECTOR COMMENT *(for CAA only)*

Name and Credentials no.	Signature	Date

Shtojca 2: Formulari i aplikimit për lejen për bartjen e armëve, municionit, eksplozivëve, gazrave të dëmshme ose helmuese, karburanteve nukleare dhe materialeve radioaktive



Application for Permission to Carry Weapons, Munitions, Explosives, Noxious or Toxic Gasses, Nuclear Fuel and Radioactive Materials

(§ 8 of the Regulation 8/2014 on the Conditions and methods of transporting dangerous goods by air)

Note: – this form applies to requests when asking for Permission for the transport of weapons and munitions, including explosives and noxious or toxic gasses, nuclear fuel and radioactive materials as required by Article 8 of the Regulation 8/2014 on the Conditions and methods of transporting dangerous goods by air. Application should be made at least 10 days before the date of the flight on which the dangerous goods are to be carried and should be submitted to the:

Civil Aviation Authority of Kosovo
Flight Safety Department
Arbëria District, Ahmet Krasniqi Str. - 10000 Prishtina
Republic of Kosovo

Failure to complete this form in full may result in a delay in processing the application. The issuing of this form does not itself constitute a permission to carry dangerous goods

1. APPLICANT DETAILS

Organisation / Company:		Tel:	
		Fax:	
Name of responsible person:		e-mail:	

2. SHIPPER

Organisation / Company:		Tel:	
		Fax:	
Name of responsible person:		e-mail:	

3. CONSIGNEE

Organisation / Company:		Tel:	
		Fax:	
Name of responsible person:		e-mail:	

4. FLIGHT DETAILS

Operator				EU-OPS Operator?	☐ Yes	☐ No
A/C Type		Date of Flight		Flight Number		
Departure Airport		Transit Airport		Destination Airport		
AWB Number						

5. REASON FOR TRANSPORTING THE ARTICLES OR SUBSTANCES BY AIR**6. STATEMENT ON THE ACHIEVED LEVEL OF SAFETY DURING TRANSPORT WHICH IS EQUIVALENT TO THAT PROVIDED IN THE TECHNICAL INSTRUCTIONS****7. WEAPONS AND MUNITIONS**

Import / Export Licence No. (please attach)		Issuing Date	
		Expiry Date	
Quantity	Calibre	Make and model of weapons/munition (rifle, pistol, etc.)	NEQ (grams)
Total NEQ			

8. DANGEROUS GOODS

UN No.	Proper Shipping Name	Class / Division	Packing Instruction	Number of packages	Type of package	Gross mass (kg)
Total						

9. ADDITIONAL INFORMATION

Commercial Names of Items and Quantity:	
Proposed packaging:	
Specific handling required:	
Specific unloading point at destination airport:	
Specific loading point at departure airport:	
Specific emergency response information:	
Other:	
<i>Please use additional sheet if necessary</i>	

10. INFORMATION PROVIDED IN THIS APPLICATION FORM AND ITS APPENDICES ARE CORRECT AND TRUE TO THE BEST OF MY KNOWLEDGE AND BELIEF

Name		Position	
Signature		Date	

11. CAA INSPECTOR COMMENT *(for CAA only)*

Name and Credentials no.	Signature	Date
		____/____/____

Shtojca 3: Formulari i aplikimit për lëshimin/ripërtëritjen e certifikatës për mallrat e rrezikshme



Application for Issuance / Renewal of Dangerous Goods Certificate

(§ 13 of the Regulation 8/2014 on the Conditions and methods of transporting dangerous goods by air)

Note: – With this form entities involved in transporting dangerous goods by air in the Republic of Kosovo should apply for approval to carry dangerous goods (Dangerous Goods Certificate) as required by Article 13 of the Regulation 8/2014 on the Conditions and methods of transporting dangerous goods by air. Application should be made at least 10 days before the date of the flight on which the dangerous goods are to be carried and should be submitted to the:

Civil Aviation Authority of Kosovo
Flight Safety Department
Arbëria District, Ahmet Krasniqi Str. - 10000 Prishtina
Republic of Kosovo

Failure to complete this form in full may result in a delay in processing the application. The issuing of this form does not itself constitute a permission to carry dangerous goods

1. APPLYING FOR

1.1	☐	Initial Issue
1.2	☐	Variation / Amendment
1.3	☐	Renewal

2. DANGEROUS GOODS CERTIFICATE DESIRED FOR

2.1	☐	SHIPPER
2.2	☐	FREIGHT FORWARDER
2.3	☐	GROUND HANDLING SERVICE PROVIDER
2.4	☐	CARGO HANDLING AGENT
